**Republika e Kosovës;**
**Kuvendi i Komunës së Junikut;**
**Numër: 02/116;**
**Datë: 31.01.2017 .**

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
Komuna Junik-Opština Junik
02/Nr.Port. | Nr.i faq | Data
2-110/932 | 2 | 06.02.2017

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 21 paragrafi 21.1 pika h) të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31.01.2017 nxjerrë:

# VENDIM

**për**

**datën e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2017**

**I.** Me këtë vendim përcaktohet data e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2017.

**II.** Datat e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2017 janë si në vijim:

II.1. Janar - 31.01.2017, e martë
II.2. Shkurt – 24.02.2017, e premte;
II.3. Mars - 31.03.2017, e premte;
II.4. Prill – 28.04.2017, e premte;
II.5. Maj - 26.05.2017, e premte;
II.6. Qershor – 28.06.2017, e mërkurë;
II.7. Korrik - 28.07.2017, e premte;
II.8. Gusht - 31.08.2017, e enjte;
II.9. Shtator - 22.09.2017, e premte;
II.10. Tetor - 27.10.2017, e premte;
II.11. Nëntor – 24.11.2017, e premte ;
II.12. Dhjetor - 29.12.2017, e premte .

**III.** Seancat solemne të Kuvendit të Komunës së Junikut do të mbahen me: 17 shkurt 2017 (Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës); 24 maj 2017 (105 vjetori i Kuvendit të Junikut) dhe 13 qershor 2017 (Dita e Çlirimit të Junikut)

**IV.** Nëse datat e përcaktuara sipas nenit II. të këtij vendimi përkojnë me ndonjë festë ose datë tjetër që nuk punohet, mbledhja do të mbahet ndonjë ditë tjetër pune.

**V.** Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar deri më tash.

**VI.** Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

*Me këtë vendim njoftohen:*

1. MAPL;
2. Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;
3. Kryetari i Komunës së Junikut;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik TOFAJ ________________

kryesues

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
**KOMUNA E JUNIKUT**
MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK

**Republika e Kosovës;**
**Kuvendi i Komunës së Junikut;**
**Numër: 02/117;**
**Datë: 31.01.2017 .**

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
Komuna Junik-Opština Junik

| 02/Nr.Port. | Nr.i faq | Data |
|---|---|---|
| 2-110/930 | 1 | 06.02.2017 |

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 3 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 22 paragrafi 4 të Statutit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31.01.2017 nxjerrë:

# VENDIM
## për
## plotësimin e përbërjes së Komisionit të Ankesave

**I.** Me këtë vendim plotësohet përbërja e Komisionit të Ankesave për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës së Junikut në Shfrytëzim/në tekstin e mëtejmë Komisioni/.

**II.** Përbërja e Komisionit nga pika II e vendimit të Kuvendit të Komunës së Junikut me numër 02/115 do të plotësohet edhe me një anëtar si në vijim:

**1. Haxhë KRASNIQI - anëtar; përfaqësues i ekzekutivit të komunës**

**III.** Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen vendimet tjera me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

**IV.** Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:
1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Anëtari nga pika II. e këtij vendimi;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut

Kuvendi i Komunës së Junikut
Faik Tofaj
kryesues

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
Komuna Junik-Opština Junik

| 02/Nr.Port. | Nr.i faq | Data |
| --- | --- | --- |
| 2-110/929 | 1 | 06.02.2017 |

**REPUBLIKA E KOSOVËS/** REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
**KOMUNA E JUNIKUT/** MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK

**Republika e Kosovës;**
**Kuvendi i Komunës së Junikut;**
**Numër: 02/118;**
**Datë: 31.01.2017 .**

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31.01.2017 nxjerrë:

# V E N D I M
## për
## plotësimin e Komitetit për Komunitete me një anëtar

**I.** Me këtë vendim plotësohet vendi bosh në Komitetin për Komunitete.

**II.** Anëtari i zgjedhur për t'iu bashkuar Komitetit për Komunitete është z. **Imer KRASNIQI**.

**III.** Detyrat, përgjegjësitë dhe mandati i këtij anëtari janë të njëjta me detyrat, përgjegjësitë dhe mandatin e anëtarëve të tjerë të Komitetit për Komunitete.

**IV.** Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha vendimet e mëparshme me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

**V.** Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. z. Imer Krasniqi;
2. Kryesuesi i Komitetit për Komunitete;
3. Kryetari i Komunës së Junikut;
4. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
5. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
6. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut
Faik TOFAJ
kryesues

Adresa:
Tel.: +386 (0) 49 760 270
http://kk.rks-gov.net/junik

# REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

## KOMUNA E JUNIKUT

MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK

**Republika e Kosovës;**
**Kuvendi i Komunës së Junikut;**
**Numër: 02/119;**
**Datë: 31.01.2017 .**

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
Komuna Junik-Opština Junik

| 02/Nr.Prot. | Nr.i faq | Data |
| --- | --- | --- |
| 2-110/924 | 1 | 06.02.2017 |

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1, nenit 40 pika e) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 39 paragrafi 39.2 të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 12 paragrafi 12.2 dhe paragrafi 12.3 të Rregullores për simbolet, titujt e nderit, dekoratat, medaljet, mirënjohjet dhe falënderimet në komunën e Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31.01.2017 nxjerrë:

# VENDIM

## për themelimin dhe përbërjen e Komisionit Vlerësues për Ndarjen e Çmimit "Dinë Mehmeti"

**I.** Me këtë vendim themelohet Komisioni Vlerësues për Ndarjen e Çmimit "Dinë Mehmeti"/në tekstin e mëtejmë Komisioni/.

**II.** Komisioni nga pika I. e këtij vendimi do të përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë.

**III.** Komisioni do të punojë në këtë përbërje:

1. Gjemile Hebibi – anëtare, përfaqësuese e KK-së Junik;
2. Ibrahim Miroci – anëtar, përfaqësues i KK-së Junik;
3. Kadri Shala - anëtar, përfaqësues i ekzekutivit të komunës;
4. Ismet Llolluni - anëtar, përfaqësues i ekzekutivit të komunës; dhe
5. ____________ - anëtar/e i/e shoqërisë civile.

**IV.** Mandati i anëtarëve të Komisionit nga pika I. e këtij vendimi përfundon me përfundimin e punës respektivisht me vlerësimin e ofertave për ndarjen e çmimit "Dinë Mehmeti".

**V.** Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me nenin 12 dhe 13 të Rregullores për simbolet, titujt e nderit, dekoratat, medaljet, mirënjohjet dhe falënderimet në komunën e Junikut.

**VI.** Komisioni për punën e tij i përgjigjet Kuvendit të Komunës së Junikut.

**VII**: Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen vendimet tjera me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

**VIII.** Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Anëtarët nga pika III e këtij vendimi;
2. MAPL;
3. Kryetari i Komunës së Junikut;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik Tofaj

kryesues

**Republika e Kosovës;**
**Kuvendi i Komunës së Junikut;**
**Numër: 02/120;**
**Datë: 31.01.2017 .**

| REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA Komuna Junik-Opština Junik | | |
|---|---|---|
| 02/Nr.Port. | Nr.i faq | Data |
| 2-110/922 | 1 | 06.02.2017 |

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 3 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 22 paragrafi 4 të Statutit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31.01.2017 nxjerrë:

# VENDIM
**për**
**plotësimin e përbërjes së Komisionit të Ankesave**

**I.** Me këtë vendim plotësohet përbërja e Komisionit të Ankesave për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës së Junikut në Shfrytëzim/në tekstin e mëtejmë Komisioni/.

**II.** Përbërja e Komisionit nga pika II e vendimit të Kuvendit të Komunës së Junikut me numër 02/115 do të plotësohet edhe me një anëtar si në vijim:

1. **Baki MIROCI –** anëtar; përfaqësues i Lëvizjes Vetëvendosje

**III.** Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen vendimet tjera me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

**IV.** Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Anëtari nga pika II. e këtij vendimi;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut

Kuvendi i Komunës së Junikut
Faik Tofaj
kryesues

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA JUNIK OPŠTINA JUNIK -II-